



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE
SEKTORI I FINANCËS DHE I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT JANAR – DHJETOR 2018

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt.06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për periudhën Janar-Dhjetor 2018, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2018.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit të vitit 2018 të miratuar, sipas programeve, artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësorë, shpenzimet operative, investimeve të brendshme, duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë.

Për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike buxheti i alokuar për vitin 2018 ishte **41.950 mije lekë** nga të cilat 37.950 mije lekë Shpenzime Korrente dhe 4.000 mije lekë Shpenzime Kapitale me financim të brendëshëm.

Nga zërat më me peshë të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2018 janë shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative si dhe projektet e investimeve .

Shpenzimet totale sipas zërave të buxhetit

Në 000/lekë

Emërtimi i zërave të Buxhetit	Buxheti 2018	Plani I periudhes progresiv	Fakti vjetor 2018	Në %
<i>Paga</i>	18.000	15.000	14.668	98%
<i>Sigurime Shoqërore</i>	2.880	2.380	2.376	100%
<i>Mallra dhe Shërbime të Tjera</i>	13.000	20.500	15.933	78%
<i>Trans per Buxh. Fam. & Individ</i>		70	70	100%
<i>Kapitale te brendshme</i>	4.000	4.000	1.992	50%
<i>Financime te huaja total</i>				
TOTALI	37.880	41.950	35.039	84%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës, organikës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.45, datë 15.04.2013 “Për miratimin e strukturës dhe të organikes së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike”. Shumat e alokuara ne buxhetin vjetor janë përkatësisht 18.000 mijë lekë për artikullin 600 dhe 2.880 mijë lekë për artikullin 601 dhe për periudhën 12 mujore të raportimit është bërë një rialokim I brendëshëm I fondeve me miratim te MFE dhe shumat e planifikuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 15.000 mijë lekë për artikullin 600 dhe 2.380 mijë lekë për artikullin 601. Shumat e realizuara për periudhën 12 mujore të raportimit janë përkatësisht 14.668 mijë lekë për artikullin 600 dhe 2.376 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në 98% ndaj totalit të alokuar. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktit të të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602) për periudhën 12 mujore të raportimit, shuma e alokuara ne buxhetin vjetor është përkatësisht 13.000 mijë lekë. Për këtë zë kemi kërkuar një fond shtesë me shkresën tonë nr.203/1 prot në datë 31.08.2018 dhe kjo shtesë fondi është bërë e mundur me shkresën e MFE nr.17667/2 datë 26.10.2018 “Transferim fondi për vitin 2018”, dhe protokolluar në ASPA në datë 29.10.2018 në vlerën **4.000.000** lekë Gjithashtu të ndodhur para faktit që asnjë shtesë fondi nuk po vinte duke penguar ecurinë e zhvillimit normal të punës në ASPA kërkuam një rialokim fondi me shkrsën tonë nr.318 prot në datë 24.10.2018. Ky rialokim fondi u bë i mundur me shkresën e MFE nr.19030/1 datë 12.11.2018 “Transferim fondi për vitin 2018” në vlerën **3.500.000** lekë.Shuma në fund te periudhës së raportimit e fondeve ne artikullin 602 behet 20.500 mijë dhe vlera e realizuar është në shumën 15.495 mijë

lekë ose 78 % ndaj totalit. Kjo vlerë e realizimit është e lidhur ngushtësisht me periudhën e alokimeve të sipërpermendura që përkonin me muajin e fundit të vitit buxhetor.

Fondi për Investime të brendshme (zëri 231), është miratuar në shumën 4.000 mijë lekë në zërin 231. Nga ky fond për periudhën 12 mujore të raportimit janë realizuar 1.992 mijë lekë. Realizimi i financimit të brendshëm është në masën 50%.

Në vijim paraqiten më të detajuar realizimet e buxhetit për 12 mujorin 2018 sipas programeve përkatëse dhe problematikat gjatë zbatimit të tij:

Fondi për Investime të brendshme (zërat 231), miratuar me buxhetin 2018 ka qenë në shumën 4.000.000 lekë. Nga kjo shume 800.000 lekë u perdorën për likuidim të një fature të prapambetur të vitit 2017. Ky likuidim është bërë nga ASPA në muajin Janar 2018. Shuma e mbetur prej 3.200.000 lekë u kërkua që të përdorej për blerje pajisje IT. Sipas pikës 3 të VKM nr.703, datë 29.10.2014 i ndryshuar, si dhe pikës 4 të Udhëzimit nr.2 datë 02.09.2013 “Për standartizimin e termave të referencës për projektet TIK në administratën publike”, ASPA paraqiti kërkesën AKSHI-t për kryerjen e procedurave të blerjes së pajisjeve hardëare TIK me qëllim përmbushjen e misionit dhe realizimin e objektivave të institucionit. Procedura për blerje të këtyre pajisjeve nuk u kryen nga AKSHI deri në datë 11.09.2018. Në këto kushte dhe duke u nisur edhe nga nevojat e reja të shkollës, me shkresën tonë nr. 230 date 12.09.2018 kërkua rialokimin e një pjese të këtij fondi dhe përkatesisht 902.000 për pajisje IT sipas kërkesës së parë bërë në fillim të vitit 2018 dhe 2.299.000 leke për të mundësuar disa investime të tjera sipas tabelës më poshtë:

Emërtimi i projektit	Buxheti 12-mujor 2018	REALIZIMI 12-mujor 2018	Ne %	Statusi i produktit
1.Blerje pajisje IT	1.701	799	20%	Pjesërisht
2.Blerje pajisje audiovizuale	1.469	1.073	73%	Plotësisht
3.Rikonstruksion godine	830	120	14%	Pjesërisht
Totali	4.000	1.992	50%	

Më poshtë ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të investimeve:

Projekti 1. Blerje pajisje IT. Investimi nuk u realizua. Për realizimin e blerjes së pajisjeve IT ne buxhetin e vitit 2018 fondi i alokuar kaloi gjithë procedurat përkatëse për miratimin e përdorimit të tij nga AKSHI, por gjatë gjithë kohës ngelëm në pritje të cngurtësimit të fondit nga MFE i cili kushtëzoi realizimin e këtij investimi. Bemë kërkesën për c’ngurtësim fondi me shkerësn tonë nr.52/4 datë 06.11.2018 dhe nga kontaktet e shpeshta me Ministrinë e Financave u vumë në dijeni që shkresa ndodhet për miratim tek zyra e Ministrit, miratim i cili u bë i mundur vetëm në datën 31.12.2018 datë në të cilën dega e Thesarit ishte e mbyllur për kryerjen e veprimeve per llogari të vitit buxhetor 2018. Kjo gjë solli mosrealizimin e investimit.

Projekti 2. Rikonstruksion godine: Investimi u realizua pjeserisht.Për këtë ka kaluar në disa hapa: Hapi I parë ishte lidhja e kontrates per “Rilevim te gjendjes egzistuese dhe punim projekti per riorganizimin e zyrave te ASPA”. Ky hap u vështirësua së tepërmi pasi kemi pasur pengesa ne gjetjen e dokumentacionit teknik të godinës gjë e cila na ka vonuar procesin. ASPA është përdoruese dhe jo pronare e godinës. Pas shumë perpjekjesh një fotokopje e dokumentacionit është gjetur në rruge jo zyrtare në datë 16.11.2018. Menjëherë është lidhur kontrata për “Rilevim te gjendjes egzistuese dhe punim projekti per riorganizimin e zyrave të ASPA”. Por në datën 25.11.2018 në kuadër të realizimit të një investimi publik nga Bashkia e Tiranës është kryer prishja e një pjese të ndërtesës në të cilën zhvillon aktivitetin Shkolla Shqiptare të Administratës Publike, proces i cili kushtëzoi vijimin e procedurave të rikonstruksionit për të kaluar në hapat e tjerë e duke cuar kështu në mosrealizimin e investimit deri në fund të vitit ushtrimor.

Projekti 3. Blerje pajisje audiovizuale. Investimi u realizua duke kaluar te gjitha fazat e prokurimit të parashikuara nga ligji prokurimit publik

Projektet me financim të huaj

Emertimi i projektit	Buxheti viti 2018	REALIZIMI vjetor 2018	Ne %	Statusi i produktit
1.Mirembajtja e E-library platform	509	295	58%	Ne proces
2.Harmonizimi i Legjislacionit Ekonomik dhe Tregtar me Acquis-në e BE-së	1.263	1047	83%	Ne proces
Totali	1772	1.342		

Projekti 1: Projekti shërben për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së software e-Library. Është një projekt në vazhdim, pritet të përfundojë sipas kontratës.

Projekti 2: Projekti është realizuar në masën 83%, dhe përfundoi sipas kontratës. Objektivi i këtij investimi ishte mbështetje për ASPA për të vendosur procedurë dhe për të forcuar kapacitetet e saj për të planifikuar dhe ofruar vetëm masa të reja të zhvillimit të kapaciteteve për punonjësit e administratës publike.